



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror
Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 97
Prishtinë, më 7.03.2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, NezirÇoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku dhe Valdete Bajrami.

Munguan: Albulena Haxhiu, Pal Lekaj dhe Milena Miliçević.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Adelina Nitaj- Lëvizja Fol; Rita Spahiu dhe Gresa Ramadani- praktikante; Eugen Cakolli- KDI; Driton Vitia dhe Sulejman Blakaj ‘Kosova Sot’; Sanije Berisha- OSBE; Ardian Kryeziu-USAID/CLE dhe Selim Thaçi- IMF.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 03.02.2017;
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
4. Shqyrtimi i Raportit plotësues me amendamente i Komisionit Funkcional nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i grupit punues në Projektligjin nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore;

6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime për të diskutuar në pikën të ndryshme për dy njoftime : Vizitë nga kryetari i Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë, z. Fatmir Xhafa, në Kosovë dhe kërkesë e ambasadorit të Zvicrës për t'u takuar me anëtarët e Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 03.02.2017

Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 03.02.2017, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin e Komisionit Funksional për projektligjin nr. 05/L për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili nuk ka amendamente por titulli i projektligjit duhet ti përmbahet një standardi vetëm plotësim por edhe ndryshim, kukërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë pati vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. I rekomandohet Komisionit Funksional që titulli i Projektligjit të riformulohet si vijon: "Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-246.

4. Shqyrtimi i Raportit plotësues me amendamente i Komisionit FunkSIONAL nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim raportin plotësues me amendamente të Komisionit FunkSIONAL nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Armend Zemaj tha se e kam lexuar rekomandimin sepse ka të bëjë me raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Legjislacion duke pohuar se pajtohem plotësisht, por duket se është pak ambicioze mbi të gjitha pa dhënë ndonjë arsytim që të harmonizohen pagat e zyrtarëve të auditimit në Zyrën Kombëtare të Auditimit. Personalisht mendoj që duhet të rregullohet kjo fushë, sepse është në kuadër të laramanisë së pagave që po ndodhë në Republikën e Kosovës, ndaj rekomandimi më i saktë do të ishte që të procedohet sa më shpejt Ligji për Pagat sepse kjo nuk i kontribuon zgjidhjes së kësaj problematike. Më parë, ne, e kemi rregulluar një normë, por kjo ka qenë e rregulluar vetëm për kryesuesit e zyrave të auditimit në nivel të sekretarit permanent ku gjithmonë është shfaqur pakënaqësi të nivelit tjetër dytësor, por edhe te niveli i zyrtarëve të auditimit. Mendoj se kjo çështje është dashur të zgjidhet mes dy komisioneve për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, si komision që i mbikëqyrë raportet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Z. Zemaj propozoi që rekomandimi i Komisionit për Legjislacion duhet të jetë që Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ta trajtojnë dhe të kenë një rekomandim unik sa i përket kësaj çështjeje, sepse nuk mund të jemi ne ato që t'i themi 'për' apo 'kundër'. Po t'i themi 'për' është në kundërshtim me arsyetimin që nuk rregullohet me ligjin për Shërbimin Civil, ndërsa këta janë vetë shërbyes civilë dhe po t'i themi 'kundër' nuk jemi kompetent me i treguar se cila është përshtatshmëria ligjore, qoftë edhe objektivi i tyre për të avancuar auditimin e brendshëm.

Selvije Halimi tha se Ligji për pagat kur do që vijë në Kuvend dhe kur do që aprovohet realisht do të ketë ndikime në krejt ligjet e tjera se ku janë caktuara pagat e përgjegjësve në njësit e përcaktuara buxhetore dhe deshe apo nuk deshe, ne do përfshihemi në ndryshim të ligjeve sepse mendohet se me këtë projektligj që ende nuk na ka ardhur të bëhet një harmonizim i pagave për të gjithë nëpunësit që marrin paga nga buxheti i Kosovës, pavarësisht niveleve, organizatave, veçantisë dhe përgjegjshmërisë në punë me këtë projektligj parashihen që rregullohen. Më tej znj. Halimi tha se tani jemi në një fazë që presim projektligjin të adresohet deputetëve dhe në të njëjtën kohë të bëhet një harmonizim i ligjeve duke pohuar se më habit faktiqë tërë Qeveria, por edhe ne si Kuvend, pa e lënë anash dhe shoqërinë civile, po diskutojmë për projektligjin e pagave i cili ka kaluar në Qeveridhe të njëjtën kohë po merremi me plotësim ndryshim të ligjit ku kërkohet të harmonizohet paga dhe pas një apo dy muaj mund të miratohet ligji i pagave ku mund të kërkohet të ndryshohet sërish, sepse nuk mund të lëmë të njëjtën çështje me dy baza ligjore. Znj. Halimi propozoi që të procedohet në Kuvend në mënyrë që ai të vendosë ose të takohen nga një përfaqësues të këtyre tre komisioneve dhe të mendojnë se si të vazhdojnë tutje me këtë çështje.

Pas diskutimeve, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të harmonizohet Komisioni FunkSIONAL me Komisionin për Buxhet dhe Financa, në Lidhje me amendamentin e propozuar në nenin 23 të Projektligjit.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i grupit punues në Projektligjin nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Kryesuesjaparaqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Grupit punues për Projektligjin nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore dhe ftoi z. Agim Ademaj në cilësinë e kryesuesit të Grupit Punues.

Agim Ademaj tha se Komisioni formoi grupin Punues për projektligjin nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimoreku, përveç anëtarëve të grupit punues,ka marrë pjesë edhe z. Armend Zemaj në të gjitha takimet. Në fillim kemi mbajtur Dëgjim Publik për këtë projektligj ku ka pasur interesim shumë të madh duke veçuar përfaqësuesit e Odës së Përmbaruesve Privat. Pas Dëgjimit Publik kemi pasurdisa takime të Grupit Punues në vazhdimësi me qëllimin më të mirë që të përafrojmë me qëndrimet që kemi pasur në procedurë e sipër. Ndryshimi esencial i këtij projektligji ka të bëjë me nenin 13 të ligjit bazik ose nenin 4 të projektligjit, i cili ka të bëjë me tarifat e efikasitetit që është një tarifë që paguhet për procedurën apo për vetë përmbarimin e cila me këto ndryshime i ngarkohet kreditorit në vend të debitorit që është me ligjin aktual. Po ashtu në këtë nen është se tarifa e efikasitetit do të jetë e negociuar në mes përmbaruesit dhe kreditorit. Gjithsej janë 22 amendamente, në 32 nene të projektligjit.Qëllimi i Ministrisë, por edhe i përkrahësve të këtij projektligji i cilika qenë USAID-gjatë krejt procedurave dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar në segmente të caktuara duke pohuar se është një përafrim ndaj ligji do të jetë efikas në zbatim të tij sepse vetëm tarifa e efikasitet ka ndryshuar nga debitori te kreditori, ndërsa tarifat e tjera mbesin të njëjta. Si grup punues po propozojmë që pragu të jetë minimumi dhe maksimumi i kësaj tarife me kusht që të ketë mundësi që brenda minimumit dhe maksimumit të ketë një konkurrencë të mirëfilltë mes përmbaruesve.Z Ademaj theksoi se përmbaruesit e kanë kundërshtuar një gjë të tillë duke pohuar se duhet të ketë konkurrencë mes përmbaruesve,sepse do t'i çojë përpara në punën e tyre dhe do të jetë më efikase dhe konkurrenente. Insistimi i tyre ka qenë që të mbetet siç ka qenë me tarifa fikse duke mos u marr me këtë problematikë.Po ashtu tek amendamente 6 kemi bërë një ndërhyrje ku thuhet ‘Përveç tarifës së efikasitetit të përmbarimit, e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përmbaruesit privat dhe kreditorit, tarifat e tjera paraprakisht paguhet nga kreditori, dhe pas përfundimit të procedurës, ato i ngarkohen debitorit’. Sa i përketafateve të përmbaruesve privat dhe bankave janë të harmonizuar mes vetë ministrisë, përmbaruesve dhe bankave të cilat kanë pasur probleme gjatë zbatimit dhe tani janë precizuar më mirë.Z. Ademaj potencoi se esenca e këtij projektligji është te neni 4 duke pohuar

se gjatë debatit kemi pasur vërejtje edhe nga policia që është dukur e arsyeshme sepse policia nuk mund të lëshohet dhe të marri barrën si kreditor në pagesën e gjobave ndaj kemi formuluar amendamentin 7, ku thuhet “Përjashtimisht paragrafit 1,2,3 dhe 4 të këtij neni, organi i cili shqipton sanksion kundërvajtës me gjobë, tarifa e efikasitetit caktohet si tarifë fikse dhe i ngarkohet debitorit”. Në fund z. Ademaj kërkoi nga anëtarët që të përkrahet raporti me amendamente i grupit punues për këtë projektligj.

Kryesuesja kërkoi sqarime për amendamentin 14, i cili ka të bëjë me afatet prej 180 (njëqindetëdhjetë) minutash dhe 60 (gjashtëdhjetë) minutash duke pyetur se a janë bazuar në standarde apo vetë keni menduar që të jenë kaq të shkurtra dhe po ashtu për amendamentin 22 duke thënë se 18 (tetëmbëdhjetë) muajmë duken shumë për që të bëjë plotësim-ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për tarifat për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përmbaruesit privatë.

Agim Ademaj tha se bankat kanë pasur problem kur përmbaruesi e ka dërguar urdhrin për mbyllje të xhirollogarisë ndërkohë që ora ka qenë 15:30 minuta në të cilën dita në vijim ka qenë e shtunë dhe e diel dhe bankat kanë reaguar, sepse nuk kanë pasur mundësi dhe afat kohor të bëjnë zbatimin e urdhrin për përbarim. Prandaj është menduar që të jenë 180 minuta të plota sepse nëse mbyllet orari të vazhdojë ditën tjetër të punës deri të plotësohet ai afat kohor. Sa i përket amendamentin 22 kemi diskutuar shumë duke bërë një kompromis mes përmbaruesve dhe ministrisë që të jetë ky afat 18 muaj.

Agim Aliu tha se ne kemi pas një shkresë të përmbaruesve privat të cilët kanë thënë se ‘do e ndërpresin aktivitetin e tyre nëse nuk bëhen disa veprime që ata i kanë kërkuar’. Në fund kemi rënë dakord që jetë 18 muaj në mënyrë që kjo të jetë një kohë edhe e akomodimit që mos të bllokohet procesi i përbarimit.

Ardian Kryeziu, USAID/CLE, duke marrë fjalën tha se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj ka qenë si periudhë edhe një lloj kompromisi, por edhe për ministrinë si mbikëqyrje. Sado që po duket një ndryshim i vogël, por në aspektin e shkeljeve potenciale me sistemin e ri dallojnë shumë, nuk është e përherëshme njësia e mbikëqyrjes dhe është llogaritur si afat optimal deri sa të bëhet njësia e përherëshme sepse është një komision ad-hoc duke pohuar se kjo ka qenë arsyeja, përveç disa interesave edhe të përmbaruesve.

Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

P e r f u n d i m

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;
- II. Projektligji nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;
- III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverballi.

6. Të ndryshme

A. Njoftim

Kryesuesjai njoftoi se ka ardhur një shkresë nga protokolli i Kuvendit të Shqipërisëku thuhet se kryetari i Komisionit të Ligjeve ka kërkuar që të realizohet një vizitë në Kosovë në muajin mars, gjegjësisht në datat 20 dhe 21 mars i shoqëruar me një apo dy anëtarë të tjerë të këtij komisioni sipas shkresës. Kryesuesja kërkoj që të bien dakord për datat sipas agjendës dhe të njëjtën kohë t'i drejtohem me shkresë kryesisë së Kuvendit për këtë vizitë.

Armend Zemajtha se sa herë komisionet kanë kërkuar vizitë janë mirëpritur nga Kuvendi i Shqipërisë dhe ne duhet ta kthejmë në të njëjtën mënyrë dhe mbi të gjitha nevoja e bashkëpunimit është reciproke dhe në çfarë do date që ata shprehin mundësinë për vizitë, ne duhet ta kemi gatishmërinë që ta bëjmë një pritje të tillë si komision.

Meqë nuk pati vërejtje kryesuesja konstatoi se aprovohen këto data 20-21 mars të vizitës së Komisionit të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe po ashtu i dërgojmë shkresë kryesisë së Kuvendit dhe po të njëjtën kohë do të barten shpenzimet për këtë vizitë.

B. Njoftim

Kryesuesjai njoftoi se ambasadori i Zvicrës, pas bisedës që ka pasur me zonja Haxhiu, ka rënë dakord që më 16.03.2017, në orën 11:30 minutanë sallën e mbledhjeve të komisionit të ftohen nga një përfaqësues i subjekteve politike në këtë takim.

Kryesuesja konstatoi se në takim me ambasadorin e Zvicrës u vendosën këto deputet:

- Albulena Haxhiu
- Selvije Halimi
- Agim Ademaj
- Danush Ademi
- Pal Lekaj
- Valdete Bajrami.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryesuesja e Komisionit,

Selvije Halimi

Aneks- Amendamentet e miratuara për Projektligjin nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e projektligjit, në rastet kur dispozita i referohet ligjit i cili ndryshohet dhe plotësohet, pas fjalës “**Ligjit**”, shtohet fjala “**bazik**”.

Amendamenti 2

Neni 2 i Projektligjit teksti “ 1. Neni 2 i Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji), paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.19 shtohet nënparagraf i ri me tekstin si në vijim:” **zëvendësohet me tekstin “1. Neni 2 i Ligjit bazik, paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.19, shtohet nënparagraf i ri 1.20, me tekstin sinë vijim:”**

Pjesa tjetër mbetet si në Projektligj.

Amendamenti 3

Neni 3 i Projektligjit teksti “Neni 3 i Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji), pas paragrafit 5 shtohet paragraf i ri me tekstin si në vijim:” **zëvendësohet me tekstin “ Neni 3 i Ligjit bazik, pas paragrafit 5, shtohet paragrafi i ri 6, me tekstin si vijon:”.**

Pjesa tjetër mbetet si në Projektligj.

Amendamenti 4

Neni 4, paragrafi 1 i Projektligjit, riformulohet si vijon:

“1. Neni 13 i Ligjit bazik, paragrafi 1, pas fjalës “kreditori” shtohet fjalia: “përveç shpenzimeve lidhur me efikasitetin e përmbarimit e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përmbaruesit privat me kreditorin”.

Amendamenti 5

Neni 4, paragrafi 2 i Projektligjit, riformulohet si vijon:

2. Neni 13 i Ligjit bazik, pas paragrafit 1, shtohet paragrafi i ri 1.a, me tekstin si vijon:

“1.a Tarifat për administrimin e rastit, si dhe tarifat tjera që paguhen nga debitori përcaktohen me akt nënligjor, të cilin e nxjerr ministri, ndërsa tarifa e efikasitetit të përmbarimit është tarifë, e cila paguhet nga kreditori vetëm pas kryerjes së përmbarimit dhe deri në vlerën e përmbaruar dhe shuma e saj përcaktohet me marrëveshje në mes të kreditorit dhe përmbaruesit privat brenda kufirit maksimal dhe minimal të përcaktuar me akt nënligjor të ministrit”.

Amendamenti 6

Neni 4, paragrafi 4 i Projektligjit riformulohet si vijon:

“4. Neni 13 i Ligjit bazik, paragrafit 4, ndryshohet dhe plotësohet si vijon:

4. Përveç tarifës së efikasitetit të përmbartimit, e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përmbartuesit privat dhe kreditorit, tarifat tjera paraprakisht paguhën nga kreditori, dhe pas përfundimit të procedurës, ato i ngarkohen debitorit”.

Amendamenti 7

Në nenin 4 të Projektligjit, pas paragrafit 4 shtohet paragraf i ri 5 me tekstin si vijon:

“5. Neni 13 i Ligjit bazik, pas paragrafit 6, shtohet paragraf i ri 7, me tekstin si vijon:

7. Përjashtimisht paragrafit 1,2,3 dhe 4 të këtij neni, organi i cili shqipton sanksion kundërvajtës me gjobë, tarifa e efikasitetit caktohet si tarifë fikse dhe i ngarkohet debitorit”.

Amendamenti 8

Neni 5 paragrafi 2 i Projektligjit teksti “Neni 22 i Ligjit, paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.7 shtohet nënparagraf i ri me tekstin si në vijim:”**zëvendësohet me tekstin**“2. Neni 22 i Ligjit bazik, paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.7,shtohet nënparagraf i ri 1.7a me tekstin si në vijim1.7a:”. Pjesa tjetër mbetet si në Projektligj.

Amendamenti 9

Neni 6 i Projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 6

Neni 43 i Ligjit bazik, paragrafi 3, pas fjalëve “llogarinë bankare”, shtohen fjalët “llogaritjen e bën banka me shpenzimet e debitorit. Në rastet ku llogaritjen e bën banka, organi përmbartues obligohet që në urdhrin përmbartimor të shënojë shkallën e saktë të kamatës, udhëzimet e sakta për kohën e llogaritjes së kamatës, si dhe të gjitha detajet e tjera të nevojshme, në mënyrë që bankave t’iu mundësohet kalkulimi i kamatës në mënyrë të saktë. Në rast se në urdhrin përmbartimor ka informata të pamjaftueshme, të paqarta, apo të pakompletuara, lidhur me llogaritjen e kamatës, organi përmbartues obligohet që të plotësojë urdhrin përmbartimor, sipas kërkesës së bankave”.

Amendamenti 10

Neni 7 i Projektligjit fjalët “në pajtim me nenin 17 paragrafi 1 të këtij Ligji”, **zëvendësohen** me fjalët “në pajtim me nenin 19, paragrafi 1 të këtij Ligji”.

Amendamenti 11

Neni 9 i Projektligjit paragrafi 2 në rreshtin e tretë fjala “**lëshuar**” hiqet dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 12

Neni 12 paragrafi 1, teksti “1. Neni 73 i Ligjit, pas paragrafi 1 shtohet paragraf i ri me tekstin si në vijim:” zëvendësohet me tekstin: “**1. Neni 73 i Ligjit bazik, pas paragrafit 1, shtohet paragraf i ri 1a, me tekstin si vijon: 1a** ”.

Pjesa tjetër mbetet si në Projektligj.

Amendamenti 13

Neni 18 i Projektligjit paragrafi 2 riformulohet si vijon:

Neni 112 i Ligjit bazik, pas paragrafit 3, shtohet paragrafi i ri 3a me tekstin sinë vijim:

“3a. Nuk përjashtohen nga përmbarimi të ardhurat e debitorit në bazë të ndihmës sociale, nëse ato janë lënë peng me vullnetin e debitorit në bazë të marrëveshjes”.

Amendamenti 14

Neni 19 paragrafi 3 i Projektligjit riformulohet si vijon:

“ 3. Organi përmbarues dërgon urdhrin për transfer të mjeteve brenda 24 (njëzetekatër)orësh, pas pranimi të njoftimit nga bankat për bllokimin e llogarisë. Nëse debitori ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare, banka obligohet që të bëjë transferin e fondeve të debitorit brenda 180 (njëqindetëdhjetë) minutash, pas pranimi të aktvendimit apo urdhrit të organit përmbarues, si dhe brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) minutash, pas kryerjes së transferit të fondeve e informon organin përmbarues se transferimi i fondeve është kryer duke shënuar kohën e marrjes së vendimit të organit përmbarues, shumën e kredisë së transferuar, numrin ose numrat e llogarive nga të cilat janë tërhequr fondet, emrin e palës, numrin e llogarisë dhe bankën ku transferi është kryer. Afati kohor i lartpërmendur llogaritet, dhe bankat janë të obliguara të veprojnë në përputhje me të, vetëm gjatë orarit të rregullt të punës së bankave, duke nënkuptuar se, nëse afati i lartpërmendur, i paraparë për transfer, nga koha e pranimi të urdhrit, e kalon orarin e rregullt të punës së bankave, atëherë llogaritja e afatit për transfer ndërpritet në kohën e përfundimit të rregullt të orarit të punës së bankave dhe afati i mbetur vazhdon të rrjedhë në ditën e ardhshme të punës së bankave”.

Amendamenti 15

Neni 21 paragrafi 2 teksti “2. Në nenin 220 të Ligjit shtohet paragraf i ri me tekstin si në vijim:” zëvendësohet me tekstin“2. Në nenin 220 të Ligjit bazik, pas paragrafit 1, shtohet paragraf i ri 1a, me tekstin si vijon: 1a”

Pjesa tjetër mbetet si në Projektligj.

Amendamenti 16

Neni 22 paragrafi 1 i Projektligjit riformulohet si vijon:

“Neni 234 i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Në seancën e parë të shitjes publike, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmimin që është më i ulët se pesëdhjetë përqind (50%) e vlerës së përcaktuar me vlerësimin e paluajtshmërisë. Ofertat fillestare në seancën e parë të shitjes publike, të cilat janë më të vogla se pesëdhjetë përqind (50%) e vlerës së përcaktuar, nuk do të shqyrtohen”.

Amendamenti 17

Neni 22 paragrafi 2 i Projektligjit riformulohet si vijon:

“2. Në qoftë se paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet në seancën e parë të shitjes publike, organi përmbarues e cakton seancën e dytë të shitjes publike, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) deri në 30 (tridhjetë) ditë. Në këtë seancë, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmim më të vogël se 1/3 e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë”.

Amendamenti 18

Neni 23 i Projektligjit paragrafi 1 në rreshtin e pestë referenca “**nenit 21**” zëvendësohet me referencën “ **nenit 22**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 19

Neni 23i Projektligjit paragrafi 2 riformulohet me tekstin sinë vijim:

2. Çmimi më i ulët, me të cilin mund të shitet paluajtshmëria, sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund të jetë më i ulët se një e treta (1/3) e vlerës së përcaktuar”.

Amendamenti 20

Neni 23 i Projektligjit paragrafi 3 në rreshtin e pestë referenca “**nenit 21**” zëvendësohet me referencën “ **nenit 22**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 21

Neni 29 paragrafi 2 teksti: “Neni 350 i Ligjit, pas paragrafi 1 shtohet paragraf i ri me tekstin si në vijim:” **zëvendësohet me tekstin “Neni 350 i Ligjit bazik, pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 1a me tekstin sinë vijim: 1a”.**

Pjesa tjetër mbetet si në Projektligj, duke renditur numrat e nënparagrafëve, sipas radhës.

Amendamenti 22

Neni 32 paragrafi 1 i Projektligjit riformulohet si vijon:

“1. Brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Drejtësisë do të bëjë plotësim-ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për tarifat për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përmbaruesit privatë”.